

Falënderimi i takon All-llahut. Atë e falënderojmë dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga All-llahu prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzon All-llahu s'ka kush e lajthit dhe kë e largon nga rruga e vërtetë, s'ka kush e udhëzon. Dëshmoj se s'ka hyjni tjetër përveç All-llahut, i Cili është Një dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij.

Besimtarë të nderuar!

Të flasësh të vërtetën s'do mend se lipset koha dhe momenti i duhur i saj por edhe të heshtësh ndaj së vërtetës kur ajo njolloset, sidomos kur ajo paraqet një bazament kyç fetar, s'do mend se është dobësi. Imam Kushejriji në Er Risaletu'l Kushejrije[1] ka thënë: "Heshtja në kohën e duhur është cilësi burrash sikur që të folurit në vendin e vet është tipar nderi. E kam dëgjuar Profesorin Ebu Alij Ed Dekkak duke thënë: Kush hesht nga e vërteta, ai është djallë memec"[2].

Nuk di se si do të arsyetohej heshtja ndaj keqinterpretimit të personalitetit të Isait, alejhi's selam, një profeti pa besimin e të cilit muslimani nuk mund të bëhet pjesëtarë i Fesë Islame. Nuk di si mund të justifikohet heshtja ndaj këtij krimi kur ofendimi i një profeti, sipas Islamit, nënkupton ofendimin e të gjithë profetëve. Pra, nëpërkëmbja e figurës së Isait, alejhi's selam, nënkupton edhe nëpërkëmbjen e Muhammedit, alejhi's selam. Thotë Allahu i Madhëruar:

"????????? ??????? ????????? ?????? ????????? ?????????? ?????? ????????? ?????? ????????????????? ????????????????? ????????????????? ????????????????? ????????????????? ?????? ????????? ?????????? ??????? ?????????? ????????????????????? ??? ?????????????? ??? ????????????? ?????????? ?????????????????????"

Ju (besimtarë) thuani: "Ne i besuam All-llahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve (të Jakubit që ishin të ndarë në dymbëdhjetë kabile), atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre pejgamberëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm atij i jemi bindur"(El Bekare, 136).

Vëllezër besimtarë!

Duke synuar mbrojtjen e profetëve, e në veçanti të Isait, alejhi's selam, tani kur ndodhemi ndërmjet festimit të Pashkëve, ndërmjet festimit katolik që kaloi dhe atij ortodoks që pritet, vendosëm që me pak fjalë t'iu informojmë për realitetin e kësaj feste[3]. Ligjërata nuk pretendon çrregullim të raporteve. E tëra që bëjmë është sqarimi i të vërtetës nga e kota dhe mbrojtja e nderit dhe personalitetit të një profeti, të cilin e Allahu i Madhëruar e dërgoi për udhëzim dhe fe të drejtë por që pasuesit e tij shtrembëruan ato parime dhe të vërtetën e zëvendësuan me të kotën.

Pashkët kanë thelb e sfond të përzier me paganizëm dhe krishterizëm. Ato simbolizojnë besëtytninë më të madhe të të krishterëve. Besimi i tyre (i gabuar) se Zoti flijoj të birin për mëkatet e njerëzve, tani përcillet edhe me një dokërr të quajtur ringjallja e Isait, alejhi's selam prej kryqit tri ditë pas ekzekutimit barbar të tij në të. Derdhja e gjakut apo kryqëzimi i Isait, alejhi's selam, siç përmend Hamude Abdulati në librin e tij Islami në fokus është një lloj besim i ngjashëm me atë pagan i njohur tek grekët, romakët, indianët dhe persianët e hershëm[4].

Muslimanë të dashur!

Kurse “Veza e ngjyrosur” nuk ka aspak të bëjë me fe. Ajo është e ndërlidhur me storie dashurie të transmetuara nga perandorë të krishterë[8].

Muslimanë të nderuar!

Islami, me aprovimin e këtyre parimeve të patjetërsuara se të gjithë profetët duhen pranuar, se nuk duhet bërë dallime ndërmjet tyre, se sharja, ofendimi apo përgënjeshtrimi i njërit prej tyre nënkupton edhe ofendimin e të gjithë atyre, na jep vetëm një fakt shtesë se ai është i vetmi i denjë për të qenë fe e njerëzimit. Ndaj, ta falënderojmë Allahun e Madhëruar për këtë mirësi që na dha dhe ta lusim Atë që të na vdesë në këtë fe. Amin!

Përgatiti : [Sedat Islami](#)

[1] Err Rrisaletu'l Kushejrijeh, El Imam Ebu'l Kasim El Kushejrijj, Metabi' muesseseti dari'sh sha'bi, 1989, Kajro, Egjipt, f.226.

[2] Kjo fjalë në shumë vende është përmendur si hadith profetik porse e vërteta është e kundërt. Shih: <http://www.saaaid.net/Doat/Zugail/30.Htm>

[3] Hutbeja është rezyme e një punimi më të gjatë përkitazi me Pashkët.

[4] Hamude Abdulati, Islami ne Fokus, përktheu Mr. Bujar Hoxha, boton: Logos-A, Shkup, 2000, f. 311.

[5] Jezusi tha: “Kurrfarë pushteti s’do të kishe mbi mua, po të mos të ishte dhënë prej së Larti...”www.kisha-katolike-gjakove.com/Meny/Ungjilli/Ungjilli_2009/Mundimi-Gjoni.htm

[6] [www.kisha-katolike-gjakove.com/ Meny/Ungjilli/ Ungjilli_ 2009/lule- ungj..htm](http://www.kisha-katolike-gjakove.com/Meny/Ungjilli/Ungjilli_2009/lule-ungj..htm)

[7] <http://www.truth.org.ye/F7/ASHA8.HTM>

[8] <http://www.muslm.net/vb/showthread.php?t=292373>